

MEMORANDUM PËR BASHKËPUNIM

QEÇP-OJQ Rrjet për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në Republikën e Maqedonisë

I. Qëllimi

Ky Memorandum për bashkëpunim (në tekstin e mëtejshëm si MB) është rezultat i iniciativës së përbashkët mes QEÇP prej Flensburgut – Gjermani dhe anëtarët e Rrjetit QEÇP-OJQ për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në Republikën e Maqedonisë (në tëkstin e mëtejshëm si Rrjeti). MB e përshkruan marrëveshjen mes palëve nënshkruese të memorandumit për implementim dhe udhëheqje të Rrjetit.

Ky Rrjet e përmirëson bashkëpunimin mes OJQ-ve anëtare kah zhvillimi dhe përmirësimi i tolerancës ndëretnike, respektimit të dallimeve dhe dialogut mes gjithë atyre të cilët jetojnë në Republikën e Maqedonisë. Sidomos, ky Rrjet OJQ tenton t'i përforcojë kapacitetet e OJQ-ve Anëtare për gjenerim të projekteve të përbashkëta dhe iniciativa të tjera me dimension të fuqishëm ndëretnik, si dhe realizimin e iniciativave të këtilla. Këto aktivitete do të shfaqen me theks të fortë në bashkëpunimin lokal, duke i shfrytëzuar maksimalisht kapacitetet e QEÇP Qendrave rajonale të OJQ-ve. Nëpërmjet këtyre Qendrave rajonale mund të promovohen projekte ndëretnike të cilat janë në përputhshmëri me prioritetet të themeluara nga ana e tyre, kurse janë drejtpërsëdrejti relevante për bashkësitë lokale.

Përfaqësuesit e OJQ-ve nënshkruese në këtë MB i përkushtohen bashkëpunimit i cili do të jetë në pajtueshmëri të plotë me principet e tolerancës, bashkëpunimit ndëretnik, transparencës dhe përcaktueshmërisë. QEÇP, e cila inicoi krijimin e këtij Rrjeti do ta ndihmojë funksionimin e tij, ashtu siç është detalisht e përshkruar në Seksionin III, në pajtim me seksionin VIII. QEÇPM, marrur gjeneralisht, nuk do të jetë në mundësi të financojë projekte të përpunuara nga ana e anëtarëve të Rrjetit, por mund të jep përkrahje për fitim të financave për projektet dhe iniciativat tjera të përpunuara në kuadër të Rrjetit, çështje e Aneksit 3.

II. Fusha e punës

Me ndihmën e këtij Rrjeti do të përmirësohen kapacitetet e OJQ-ve Anëtare edhe në aspekt të krijimit dhe implementimit të projekteve ndëretnike. Kjo përfshin stërvitje dhe masa tjera për përforsim të kapacitetit. Më tej, kredibiliteti i OJQ-ve Anëtare do të

përforcohet me të punuarit në pajtueshmëri me kodeksin e përbashkët të sjelljes të përmbajtur në kriteret për anëtarim (Aneksi 1, si dhe Kodeksin e përbashkët të sjelljes të dhënë Aneksin 2). Rrjeti, gjithëashtu do ta përkrah zhvillimin e projekteve të përbashkëta ndëretnike, përfaqësimin e tyre para donatorëve dhe implementimin e tyre në pajtueshmëri të rreptë me këto kriteriume.

Rrjeti do të jetë i përkrahur nga resurse informative të bazuara në Eëb. Këto resurse ofrojnë mundësi për OJQ-të Anëtare të ekspozojnë profilin e tyre të punës, si dhe detaje për aktivitetet e tyre. Më tej, resurset do të përmbajnë informata vitale, relevante për OJQ-të Anëtare, në drejtim të përpunimit të projekteve përgatitore, mundësive për financim dhe praktika të dobishme nga realizimi i projekteve.

Njëkohësisht, Rrjeti do të zbulojë mënyra me të cilat do të dallohet kontributi i fuqishëm të cilin OJQ-të mund ta japin për zhvillimin e shoqërisë qytetare në Republikën e Maqedonisë. Kjo inkuadron lobim të përbashkët që të krijohet mjedis në të cilin OJQ-të të përkushtuara principeve të këtij Rrjeti do të mund të zhvillohen dhe t'i kryejnë mandatet e tyre efikasht.

III. Aksioni Gjeneral

Organizatat joqeveritare – anëtare të Rrjetit do të angazhohen në projekte të përbashkëta dhe iniciativa rreth të cilave do të mirren vesh, në pajtueshmëri me standardet e përbashkëta për transparencë dhe kualitet të realizimit, të miratuara nga ana e Rrjetit (Aneksi 2). Qëllimi i përgjithshëm i projekteve të këtilla është sigurimi i dobive për të gjithë qytetarët në baza të forta.

Aktivitetet fillestare në nivel nacional (për aktivitete lokale, shih Aneksin 3) do të përfshijnë:

1. Identifikim i OJQ-ve tjera anëtare
2. Formimi i Trupit koordinativ
3. Përcaktimi i kriterëve për mirëmbajtje dhe funksionim më të mirë të Rrjetit.
4. Kryrje e aktiviteteve të përbashkëta për përkrahje të iniciativave të OJQ-ve anëtare.
5. Udhëheqje e diskutimeve për masa konkrete, të cilat mund të mirren për përmirësim të klimës së bashkëpunimit, bashkëjetesës dhe tolerances së përbashkët në sektorin e OJQ-ve.
6. Mbajtje e mbledhjeve për përpunim të iniciativave të përbashkëta ndëretnike.
7. Stimulim i propozimeve të përbashkëta projektuese nga disa OJQ anëtare të Rrjetit.
8. Përfaqësim i përbashkët i Rrjetit para donatorëve potencial ndërkombtar.
9. Resurs i përbashkët elektronik për aktivitetet e Rrjetit dhe organizatat joqeveritare të cilat janë anëtarë të tij, për praktikatat e mira për përgatitje të projekteve dhe realizimin e tyre dhe për mundësitë për financim.
10. Stërvitje për përfaqësues të OJQ-ve për përgatitje të projekteve dhe temave tjera të interesimit.

IV. Struktura e Rrjetit

Rrjeti është iniciativë vullnetare e OJQ-ve të cilat kanë vendosur të bashkëpunojnë në pajtueshmëri me standardet e përbashkëta për kualitet, me qëllim të realizimit të qëllimeve të lartpërmendura. Si iniciativë, Rrjeti nuk ka status të trupit ligjor, edhe pse kjo me kohë mund të revidohet.

Me qëllim që të mbahen aktivitetet e Rrjetit, do të shfrytëzohen mekanizmet e mëposhtme:

Kuvendi

Kuvendin e Rrjetit e përbëjnë të gjitha palët nënshkruese në Rrjet.

Kuvendi pranon anëtarë të rinj në Rrjet në pajtueshmëri me kriteriumet e dhëna në Aneksin 1.

Kuvendi i Rrjetit mbledhet me përbërje të plotë, së paku një herë në vjet. Në këto mbledhje zgjidhet Trupi koordinues.

Trupi koordinues

Kuvendi prej përbërjes së vet zgjedh Trup koordinues. Trupin koordinues e përbëjnë dymbëdhjetë persona nga OJQ-të, dhe një përfaqësues i QEÇP

Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Trupit koordinues duhet të mundohet që ai të pasqyrojë përbërjen multietnike të Rrjetit, si edhe përfaqësimin e rajoneve në të cilat janë të bazuara Qendrat rajonale.

Trupi koordinues zgjedh Kryetar.

Trupi koordinues mbledhet sipas nevojës me kërkesë të Kryetarit ose prej më së paku 1/3 e anëtarëve të Trupit koordinues.

- ✓ Mandati i trupit koordinues do të jetë për një vjet me të drejtën për rizgjedhje.
- ✓ Trupi Koordinues mund të emërojë zëvendës Kryetar, i cili do t'i ndihmojë Kryetarit atëherë kur ka nevojë ose gjatë mungesës së tij.
- ✓ Të konvokojë mbledhje të trupit koordinues së paku çdo tre muaj.
- ✓ Participim në proceset e sjelljes së vendimeve (me mundësinë të sjell vendime) në pajtueshmëri me kriteriumet e QEÇP-së për aprovim të projekteve.
- ✓ T'i jep prioritet projekteve në nivel nacional, të cilat mund të ndikojnë në dhe të cilat kanë të bëjnë me sferat institucionale (lobim, ndryshime në legjistaturë, etj.)
- ✓ Të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të trupit koordinues.
 1. T'i ndjekin mbledhjet.
 2. Të kontribuojnë në punën e trupit koordinues.
 3. Të participojnë në proceset e sjelljes së vendimeve, si përfaqësues të pavarur të TK të Rrjetit.
 4. Të participojnë dhe kontribuojnë në punën e komiteteve

Detyrat dhe përgjegjësitë e Trupit koordinues

Trupi koordinues e merr përgjegjësinë kryesore për implementimin e planit të aktiviteteve të Rrjetit. Në pajtueshmëri me këtë, Rrjeti është përgjegjës për:

- **konvokim të Trupit koordinues**, duke inkuadruar edhe caktim të mbledhjeve, kontakte të rregullta dhe edukim të anëtarëve të Trupit koordinues, distribuim të rendit ditor, sigurim të materialeve, dhe punë tjera plotësuese në pajtim me nevojat.
- **konvokim të anëtarëve të Rrjetit**, duke inkuadruar edhe zgjedhje dhe ftesë lehtësuesëve dhe anëtarëve, distribuim të rendit ditor, materiale përcjellëse, dhe punë tjera plotësuese në pajtueshmëri me nevojat.
- **krijim i strategjisë për mirëmbajtje të rrjetit**
- **lobim i përbashkët në dobi të Rrjetit**
 - **plan për lobim të jashtëm** – prezentim i Rrjetit para strukturave të ndryshme, lobim dhe përfaqësim i po të njejtës
 - **plan për lobim të brendshëm** – inkuadron promovim të iniciativave për zhvillim të shoqërimit dhe bashkëpunimit, organizim i diskutimeve të anëtarëve të brendshëm dhe shpërndarje të aktiviteteve gjitha palëve të interesuara
 - **mbajtje e kontakteve konstante** nëpërmjet së paku një mbledhjeje formale të përbashkët vjetore me komitetet ekzekutuese dhe Qendrat Rajonale.
 - Rrjeti do të mbajë pres konferenca çdo tre muaj me qëllim të prezentimit të aktiviteteve të tij, problemet me të cilat ballafaqohet, is edhe me planet për të ardhmen.
 - Trupi koordinues do të zgjedh komitete të sektoreve dhe lloje të tjera të komiteteve të duhura për suksesin e Rrjetit, duke u bazuar në iniciativën e QR-së ose një numri të antëtarëve, që është në pajtueshmëri me kriteriumet për sjelljen e vendimeve të pavaruara si dhe në pajtueshmëri me Aneksin 3 të MpB.

T'i shqyrtojë raportet vjetore të Qendrave Rajonale dy jave para Kuvendit Gjeneral dhe të njetat t'ia dërgojë Trupit Koordinues.

V. Përcjellje e rezultateve të iniciativës

Përparimin e aktiviteteve të Rrjetit do ta ndjekin Trupi koordinues, Kuvendi dhe palët nënshkruese, nëpërmjet zhvillimit dhe ndërtimit të ëeb-faqes së përbashkët dhe materialeve tjera informuese të iniciativës dhe Rrjeti. Kuvendi do ti shqyrtojë raportet vjetore të qendrave Rajonale dhe raportin vjetor të trupit koordinues në lidhje me aktivitetet nacionale.

Do të përmbush pjesën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhënë në nenin VII. Kuvendi do ta shqyrtojë raportin vjetor të Qendrave Rajonale dhe të Trupit Koordinues. Trupi Koordinues do t'i prezentojë shikimet e veta për punën e Qendrave Rajonale.

VI. Procesi i sjelljes së vendimeve

Rrjeti ose qendrat rajonale nuk udhëheqin me aktivitetet e OJQ-ve anëtare të realizuara jashtë kompetencave të Rrjetit. Faktikisht, vendimet e sjellura nga këto trupa të formuar do të jenë në pajtueshmëri me funksionimin dhe aktivitetet e Rrjetit, Qendrave rajonale dhe projektet e realizuara në mbikqyrjen e tyre.

Vendimet e Kuvendit sillen me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve. Vendimi për përjashtim të ndonjë antëari të anëtarsuar nga ana e Kuvendit sillet me shumicë prej dy të tretave prej të gjithë anëtarëve në bazë të mospërbajtjes së qartë të Doaracakut për praktika të mira të përmbajtur në Aneksin 2. Sa i përket anëtarit të anëtarsuar nga Qendra rajonale, dhe e cila qartë nuk i përmbahet Kodeksit për sjellje të OJQ-ve anëtare të dhënë në Aneksin 2, i njejtë mund të përjashtohet nga anëtarsia me shumicë prej dy të tretave të të gjithë anëtarëve të Qendrës rajonale përkatëse. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Trupi koordinues nëpërmjet shumicës së dy të tretave.

Trupi koordinues sjell vendime nëpërmjet shumicës së anëtarëve të tij.

Vendimet që i përkasin çështjeve të financimit dhe rolit dhe funksioneve të QEÇP mund të hyjnë në fuqi vetëm me aprovimin e QEÇP.

Ky paragraf është materie e seksionit VII

VII. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet në lidhje me punën e Rrjetit mund të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve në Trupin koordinues. Nëse rekomandimi i Trupit koordinues për mënyrën e zgjedhjes së mosmarrëveshjes nuk është i pranueshëm për njërin ose më shumë palë relevante, ose nëse nuk mund të arrihet pajtueshmëri me shumicë të thjeshtë të votave, atëherë themelohet Komision për zgjidhje të mosmarrëveshjeve të brendshme i përbërë prej një anëtari të Trupit koordinues, një anëtari nga QEÇP dhe një anëtari të nominuar bashkarisht nga të dy palët. Organizata e cila nuk i përcjell rekomandimet e këtij Komisioni do të përjashtohet nga Rrjeti me shumicë të thjeshtë të votave të Trupit koordinues.

Nëpërmjet mekanizmit të njejtë do të zgjidhen edhe mosmarrëveshjet në lidhje me projektet e përbashkëta të realizuara nën mbikqyrjen e Rrjetit, të cilat nuk mund të zgjedhen me konsultime mes projekt partnerëve, ose me inkuadrim të përfaqësuesit rajonal prej QEÇP, në periudhe kohore prej dy muajsh nga fillimi i mosmarrëveshjes nga cila do palë në Trupin koordinues.

TK do t'i dëgjojë apelet lidhur me pranimin e anëtarëve në një Qendër Rajonale, nëse një apel i tillë është bërë nga së paku dy anëtarë të asaj Qendre Rajonale. TK mund të

pranojë anëtarin si anëtarë partner për deri sa pret vendimin e Kuvendit Gjeneral për këtë çështje.

VIII. Financimi i Rrjetit

Për 2001, QEÇP siguroi financim për të ndihmuar themelimin dhe punën fillestare të Rrjetit. Mbështetja shpirtgjerë e Ministrive për punë të jashtme të Danimarkës dhe Norvegjisë, në këtë kontekst përmendet me respekt. Pritet se mund të sigurohet financim i ngjashëm, ndoshta edhe plotësues për mbështetje të aktiviteteve të Rrjetit për 2002. Planifikimi për 2002 do të drejtohet kah sigurimi i mirëmbajtjes afatgjate të Rrjetit.

Vetë Rrjeti, i marrë në përgjithësi, nuk do të financojë projekte të përbashkëta, lëndë e Aneksit 3. Prapëseprap, Rrjeti do të ndihmojë në prezentimin e projekteve të përbashkëta para donatorëve potencial.. Këtu përfshihen misionet lokale të vendeve – donatore, organizatave ndërkombtare dhe fondacioneve dhe Paktit për stabilitet për Evropën Juglindore. QEÇP si pjesë e Rrjetit, qëndron në disponim për përcjelljen e implemetimit të projekteve për të cilat është fituar financim si rezultat i mundeve të dhëna në kuadër të ombrellës së Rrjetit.

Nëpërmjet Qendrve rajonale të veta, Rrjeti e mban të drejtën të sigurojë financim direkt përkatës për projekt iniciativat të cilat premtojnë rezultate të shpejta dhe të dukshme për të gjitha bashkësitë në lokalitetet e dhëna, siç është përshkruar detajisht në Aneksin 3.

IX. Dispozitat përfundimtare

1. Ky Memorandum për bashkëpunim do të jetë në fuqi në kohëzgjatje prej dy vitesh dhe do të jetë i vazhduar për një periudhë të ardhshme dyvjeçare pa nevojë për veprimtari të mëtejshme, përveç nëse nuk vendoset ndryshe. Për anëtarin si kontinuuar në QEÇP, prapëseprapë do të ketë nevojë për mbështetje vjetore.
2. Kushtet e këtij Memorandumi për Bashkëpunim mund të plotësohen ose mprehen me shumicë prej dy të tretave të anëtarëve prezent në mbledhje, me kusht që të jenë prezent së paku gjysma e anëtarëve. Sërish, ndryshimet që i përkasin rolit ose përgjegjësisë së QEÇP do të efektuohen vetëm më aprovimin e QEÇP.
3. Çdo OJQ anëtare e rrjetit mund me vendim të vet te heq dorë nga anëtarësia në rrjet. Vendimin e saj duhet ta dorëzojë në formë të shkruar deri tek Trupi koordinues dhe vendimi të hyjë në fuqi një muaj pas marrjes së lajmërimit. Nëse OJQ-ja anëtare e cila don të çantaresohet është e inkuadruar në projekt të përbashkët, të formuar nëpërmjet strukturave rajonale dhe nacionale të Rrjetit, mund të heq dorë nga anëtarësia vetëm në momentin e përfundimit të projektit, siç është e dhënë në propozim projektin. Prapëseprap, nëse të gjithë partnerët në projekt pajtohen që OJQ-ja e cila don të heq dorë nga anëtarësia e saj të mund ta bëjë këtë, atëherë do të mund ta bëjë këtë ashtu siç u përmend në fjalinë e parë të këtij paragrafi.

A N E K S I 1

KRITERIUME PËR PRANIM DHE ANËTARSIM NË QEÇP RRJETI PËR PËRMIRËSIM TË MARRËDHËNIEVE NDËRETNIKE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

1. OJQT-të – anëtare të Rrjetit duhet që në kuptim më të gjerë ta pasqyrojnë përbërjen etnike të Republikës së Maqedonisë.
2. OJQT-të – anëtare duhet të promovojnë dhe inicojnë aktivitete në interes të të gjitha bashkësive.
3. OJQT-të – anëtare duhet të promovojnë ide për bashkëpunim me grupe të ndryshme etnike dhe bashkësi të ndryshme dhe bashkarisht të angazhohen dhe kontribuojnë për implementimin e tyre.
4. OJQT-të – anëtare duhet të jenë të hapura për bashkëpunim me institucionet të cilat janë të interesuara për promovim dhe avancim të bashkëpunimit ndëretnik.
5. OJQT-të – anëtare duhet ta mbështesin lobimin e Rrjetit, me qëllim të realizimit të qëllimeve të përcaktuara bashkarisht.
6. Rrjeti nuk do të jetë i hapur për OJQ-të të cilat kanë prapavijë ose qëllime partiake.
7. OJQT-të – anëtare duhet që të jenë transparente në punën e tyre dhe të sinqerta para anëtarëve të tyre dhe donatorëve.
8. Të gjithë anëtarët e OJQ-ve janë të obliguar ta respektojnë Memorandumin për Bashkëpunim.
 9. Anëtarët e rinjë do t'i propozojë një OJQ – anëtare e Rrjetit, kurse për propozimin nevojitet përmbajtje e edhe një OJQ – anëtare në Qendrën Rajonale. Çështje e nenit VII të MpB. . .
10. Me nënshkrimin e Memorandumit për bashkëpunim, OJQ-të formalisht bëhen anëtare të rrjetit me vendimin e Kuvendit/Qendrës Rajonale.
11. Në rast të mosrespektimit të kriteriumeve të lartpërmendura, Rrjeti e mban të drejtën për përjashtim të anëtarit.
12. Të gjithë anëtarët janë të obliguar të veprojnë sipas konkluzioneve të organeve të Rrjetit.

A N E K S I 2

KODEKS I SJELLJES

Për OJQ-të anëtare të “QEÇP OJQ Rrjetit për përmirësim të marrëdhënieve ndëretnike në Republikën e Maqedonisë”

A. Vlerat

Sa do edhe që të jenë të ndryshme aktivitetet tona, ne kemi sisteme të përbashkëta të vlerave. Bazuar në dëshirën të avancohen dhe përmirësohen jetat e njerëzve, të luftohet kundër varfërisë dhe jobarazisë; në përcaktimin të rritet bashkëpunimi mes OJQ-ve, të cilat janë anëtare, kah zhvillimi dhe përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike mes gjithë atyre që jetojnë në Republikën e Maqedonisë; dhe të vendosur t’i përforcojmë kapacitetet e OJQ-ve, të cilat marrin pjesë, për të gjeneruar projekte të përbashkëta dhe iniciativa të tjera me dimension të fuqishëm ndëretnik dhe t’i implementojmë iniciativat e tilla, ne marrim obligim për vlerat themelore të mëposhtme të cilat i përkrah misioni dhe qëllimet e nënshkruesëve të MB. Për këtë arsye, ne marrim obligim që:

- Në punën tonë të jemi të udhëhequr nga principet e përgjithshme të tolerancës, respektimit të dallimeve dhe dialogut.
- T’u përgjigjemi nevojave dhe mirëqenies së njerëzve në Republikën e Maqedonisë.
- Përgjegjësi dhe transparencë.
- Demokraci participuese.
- Zhvillim i fokusuar mbi njerëzit.
- Respektim i të drejtave, kulturës dhe krenarisë së të gjithë njerëzve.
- Sigurim organizata t’i mbetet besnike misionit dhe qëllimeve të saja.
- Avancim i volonterizmit, dhe involvim aktiv volonter në të gjitha nivelet.
- Bashkëpunim i ndërsjellë, kolaboracion dhe punë rrjetore me agjensione tjera në lidhje më pyetje nga interesi i përbashkët.
- Synim kah shkëlqyeshmëri, duke inkuadruar edhe dhënie efikase të shërbimeve në të gjitha nivelet.

B. Udhëheqje

Efikasiteti i punës sonë varet nga strukturat udhëheqëse e çdo organizate. Si organizata profesionale, e konfirmojmë rëndësinë e formimit dhe mirëmbajtjes së trupave të aftë, të cilat do të udhëheqin me funksionimin e brendshëm të organizatave tona individuale. Individë të përkushtuar, më përvojë dhe përgjegjësi janë pjesë e rëndësishmë për gjithë këtë. Për këtë qëllim, ne:

- Do të sigurojmë që organizata të ketë vizion të qartë, qëllime dhe politika, dhe t'u përmbahet të njejtave
- Do ta konkretizojmë frekuencën e mbledhjeve, kворumet dhe rolin dhe autorizimet e strukturës udhëheqëse
- Do të zhvillojmë politikë, e cila do të ndalojë ndeshje direkte apo indirekte të intereseve nga ana e strukturës udhëheqëse, anëtarëve, të punësuarëve dhe volonterëve. Do të sigurojmë që anëtarët e strukturës udhëheqëse dhe të personelit të jenë të liruar nga vendimet ku ata kanë, apo qartë shihet që kanë përfitim interesi
- Në rast të Bordit apo Kryesisë së pavarur, do të sjellim politikë e cila do t'i destimulojë anëtarët të dërgojnë tendere deri tek organizata ose të konkurojnë për vende tek personeli në kuadër të organizatës. Kjo politikë duhet të stipulojë se nëse ata duan ta bëjnë njërin apo tjetrën, atëherë duhet të tërhiqen nga struktura udhëheqëse
- Do të sigurojmë që struktura udhëheqëse ta kuptojë dhe të mbajë përgjegjësi për sjelljen e përgjithshme të vendimeve dhe të pranojë përgjegjësi finale për udhëheqjen e të gjitha aspekteve të organizatës
- Në kuadër të limitimeve financiare, do të sigurojmë që struktura udhëheqëse ta reflektojë përbërjen etnike të shoqërisë së Maqedonisë dhe shfrytëzuesëve të ndryshëm të përfshirë me të cilët punojnë OJQ-të, nga aspekti i përbërjes së tyre dhe shpërndarjes së tyre gjeografike si dhe të dy gjinitë të jenë njësoj të përfaqësuara
- Do të sigurojmë të bëhet vlerësim i nevojave nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me numër reprezentues të beneficuesëve para zhvillimit të vetë propozim-projektit. Anëtarët do të sigurojnë që i tërë procesi i dizajnit dhe implementimit të projektit të jetë i udhëhequr nga nevojat e shfrytëzuesëve.

V. Standarde të bashkëpunimit mes OJQ-ve anëtare

Standarde të përgjithshme

- OJQ-të anëtare do të jenë të hapura për bashkëpunim me OJQ-të tjera në ballafaqimin me nevojat dhe dëshirat e bashkësisë / shfrytëzuesëve të cilëve u shërben ajo OJQ.
- OJQ-të anëtare do ta inkurajojnë dhe mbështesin zhvillimin e OJQ sektorit në nivel rajonal si edhe në nivel nacional.
- OJQ-të anëtare do të jenë të hapura për përcjellje të informatave dhe diturive për funksionimin e OJQ sektorit, për OJQ-të e reja dhe të ardhshme.
- OJQ-të anëtare aktivisht do të angazhohen në shkëmbimin e informatave me OJQ-të tjera për ta lehtësuar aksionin e përbashkët dhe t'u shpallin dyfishimit të mundimeve.
- OJQ-të anëtare do ta inkurajojnë bashkësinë OJQ lokale që së bashku të angazhohen në kontakte dhe bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale, sektorin privat dhe mediumet, për ta përmirësuar efikasitetin e sektorit.

Standarde të bashkëpunimit mes OJQ-të anëtare OJQ-ve anëtare të cilat janë anëtarë në kuadër të Qendrës Rajonale dhe në kuadër të Rrjetit Nacional

- OJQ-të anëtare do të punojnë në shpirtin e bashkëpunimit, besimit të ndërsjellë, tolerancës dhe respektimit të dallimeve.
- OJQ-të anëtare do të sigurojnë që të ketë shkëmbim të rregullt të informatave mes tyre për aktivitetet dhe iniciativat e tyre.
- OJQ-të anëtare do të sigurojnë që shfrytëzuesit e tyre individual dhe rrjeti i bashkëpunorëve të jenë të vetëdijshëm për aktivitetet e Qendrës rajonale / Rrjetit nacional.
- OJQ-të anëtare do të gjejnë mënyra për ndarje dhe diseminim të diturisë të përfituar nëpërmjet programeve të ndryshme për stërvitje në të cilat ata kanë marrë pjesë.
- OJQ-të anëtare do të tentojnë të gjejnë mënyra për zgjidhje të mosmarrëveshjeve dhe konflikteve mes tyre nëpërmjet dialogut konstruktiv dhe analizës së problemit.
- Në rast të pamundësisë konflikti të zgjidhet mes OJQ-ve të cilat janë anëtare siç është përcaktuar më lart, do të vijojë procedura e përcaktuar në Memorandumin për bashkëpunim.

- OJQ-të anëtare do të synojnë që nëpërmjet Qendrave rajonale t'i koordinojnë aktivitetet e tyre në lobimin për arsyet e shfrytëzuesëve me vetëqeverisjen lokale dhe sektorin privat.
- OJQ-të anëtare do të synojnë që nëpërmjet Rrjetit nacional t'i koordinojnë aktivitetet e tyre në lobimin për arsyet e shfrytëzuesëve me Qeverinë dhe sektorin privat.

Standarde të bashkëpunimit mes partnerëve në projekte të përbashkëta

- Në formimin e federatave projektuese, OJQ-të të cilat janë anëtare do të udhëhiqen nga dëshira, aftësia dhe kapaciteti i partnerëve, dhe jo vetëm nga nevoja të ketë ekipë me strukturë të ndryshme etnike.
- Federata projektuese mes OJQ-ve të cilat janë anëtare do të bëhen pas diskutimit elaborues të qëllimeve, sqarimit dhe shfrytëzuesëve të projektit të propozuar.
- OJQ e cila e propozon projektin do të jetë OJQ-ja udhëheqëse dhe për atë projekt konkret do të përfaqësojë pikë kontaktuese me donatorin, agjensionet lokale dhe mediumet.
- Pas adaptimit të qëllimeve dhe sqarimit të projektit, partnerët në projekt do të marrin pjesë në dizajnimin e projektit dhe në definimin e rolit të organizatës së tyre individuale. Kjo do të përfshijë edhe detyra dhe përgjegjësi të partnerëve të veçantë në dizajnimin dhe implementimin, si dhe pasojat financiare nga participimi.
- Kur prezentohet propozim-projekt i përbashkët deri tek agjensionet të cilat do ta kishin financuar projektin, emri i OJQ-së udhëheqëse dhe partnerëve të saj në projekt do të prezentohet haptazi dhe qartë.
- Në fazën e implementimit të projektit, OJQ-ja udhëheqëse do të jetë përgjegjëse për projektin.
- Në fazën e implementimit të projektit, OJQ-të me më shumë përvojë në kuadër të federatës përkatëse projektuese, do ta ndajnë dhe përcjellin diturinë anëtarëve me më pak përvojë, kështu që do të kontribuojnë në strategjinë e përgjithshme për rritjen e kapaciteteve të OJQ-ve.
- Në të gjitha kampanjat për diseminim të informatave të cilat kanë të bëjnë me projektin e përbashkët, do të përmenden emrat e të gjithë bashkëpunorëve.
- OJQ-të anëtare do të bëjnë çdo gjë që të sigurojnë që çdo mosëmarrvëshje apo konflikt që buron brenda në federatën projektuese të zgjidhet nëpërmjet diskutimit

dhe dialogut konstruktiv. Në rast se nuk veprohet ashtu, do të vijojë procedura e përcaktuar me Memorandumin për bashkëpunim.

- OJQ-të anëtare do ta promovojnë idenë e punës ndëretnike kolaborative me dhënie të shembujve pozitiv nëpërmjet implementimit të suksesshëm të projekteve të përbashkëta ndëretnike.
- OJQ-të anëtare do të bëjnë çdo gjë të mësojnë leksione nga implementimi i projektit të përbashkët nëpërmjet identifikimit të problemeve dhe si po të njëjtat mund të tejkalohen si dhe nëpërmjet praktikës së suksesshme. Këto informata do të ndahen me anëtarët e Rrjetit nëpërmjet ëeb-faqes së Rrjetit, dhe me qëllim që kjo të bëhet resurs me vlerë për tërë bashkësinë e OJQ-ve.

G. Përgjegjësi

Synimi ynë të avancohet demokracia është e bazuar në kulturën e participimit dhe përgjegjësisë së plotë në kuadër të organizatave tona. Çelësi është transparenca në tërë punën të cilën e bëjmë. Për këtë qëllim:

- Ne do të zhvillojmë mekanizma të cilat do t'u mundësojnë të gjithë investuesëve tonë të jenë të involvuar në programet për planifikim të cilat kanë pasoja drejtpërdrejtë pas tyre.
- Ne do të sigurojmë mundësi për vlerësime të rregullta dhe azhurim të programeve të cilat përfshijnë kontribut të bashkësisë dhe të investitorit.
- Ne do të mbajmë kuvend të përgjithshëm vjetor, me publikim të plotë, të hapur dhe preciz të informatave relevante që kanë të bëjnë me qëllimet, programet, financat dhe udhëheqjen. Kjo do të sigurojë përgjegjësi kah shfrytëzuesit dhe donatorët.
- Ne do të mbajmë mbledhje të rregullta strategjike planifikuese në të cilat investitorët më të rëndësishëm janë të ftuar të japin kontribut.

D. Menaxhmenti dhe resurset njerëzore

Kapacitetet e njeriut dhe liderizmi i aftë janë komponentë kritike e efikasitetit të punës sonë. Do të tentojmë t'i ndëjm praktikat më të suksesshme të menaxhmentit të cilat janë kompatible me misionin, të punuarit dhe strukturën udhëheqëse të organizatës. Për këtë qëllim:

- Ne periodikisht do të bëjmë vlerësim të sërishëm të misionit, qëllimeve dhe të punuarit e organizatës, në dritë të konteksteve dhe nevojave variabile të shfrytëzuesëve.

- Ne në mënyrë kritike do ta analizojmë praktikën tonë personale dhe kulturën tonë organizuese dhe do t'i bëjmë ato ndryshime të cilat janë të nevojshme për ndërtim të kulturës e cila inkurajon kreativitet, dallueshmëri, përgjegjësi dhe respekt që do t'i pranojë të gjitha grupet kulturore si partnerë të barabartë në zhvillimin e organizatës.
- Ne do të zhvillojmë politikë dhe veprime të qarta, mirë të definuara dhe të shkruara, të cilat do të duhet të ndiqen, dhe të cilat do të vlejné për të gjithë të punësuarit, anëtarët dhe volonterët.
- Ne do të themelojmë dhe mirëmbajmë procedura disiplinuese dhe ankuese me vijat të qarta të autoiritetit dhe përgjegjesisë.
- Ne do të kemi veprime të qarta dhe transparente gjatë punësimit të personelit të ri, dhe gjatë përjashtimit të personelit ekzistues.
- Ne do të kemi politika të qarta zhvilluese kadrovike të cilat kanë për qëllim t'i mundësojnë tërë personelit dhe gjithë volonterëve t'i rrisin aftësitë e tyre që të mund të njejtat ti shfaqin në nivele më të larta të përgjegjesisë.
- Ne do të zhvillojmë sisteme adekuate dhe të pranueshme të vlerësimit të aftësive, eksperiencës dhe kualifikimeve, niveleve të përgjegjesisë dhe përformimit, dhe do të japim kompensim në këtë bazë.
- Ne do ta inkurajojmë menaxhmentin të promovojë stile interaktive të udhëheqjes dhe politikë të "derës së hapur" për t'u lehtësuar komunikimi i mirë mes të punësuarëve dhe menaxhmentit.

OJQ-të kanë nevojë të vënë prioritet në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e strategjive adekuate të udhëheqjes me financa. Financat tona do të jenë të udhëhequra që të sigurohet shfrytëzimi i rregullt i mjeteve dhe përgjegjësi para anëtarëve dhe donatorëve. Për këtë qëllim:

- Ne do t'u përmbahemi praktikave gjeneralisht të pranura të konatbilitetit dhe revizionit.
- Ne do të formojmë sisteme financiare adekuate dhe do të sigurojmë punësim të pesonave të kualifikuar të mirren dhe udhëheqin këto sisteme.
- Ne do të kryejmë revizione vjetore për të ardhurat dhe harxhimet
- Ne do të kemi politikë të qartë për huazimet dhe progreset e të punësuarëve.
- Ne do të themelojmë mekanizma që të sigurojmë që veprimet tona për pajisje me prodhime dhe shërbime të jenë të liruara nga përfitime të interesit të individëve në organizatat tona dhe të njejtat të jenë në funksion të redukimit të harxhimeve.

- Ne do të përgatisim projekt real ose buxhete të organizatës, kurse pastaj do të bëjmë mbikqyrje dhe do t'u përmbahemi. Në instanca kur duhet të bëhen ndryshime, duhet të bëhen konsultime adekuate dhe të shënohen të gjitha amandmanet.
- Ne formalisht dhe publikisht do të akuzojmë anëtarët për çdo tentim për të bërë mashtrim, vjedhje apo keqpërdorim.
- Kur do të jetë e mundshme, ne do të sigurojmë që baza e financimit të organizatës të jetë prej burimeve të nrdyshme.
- Ne do t'i mbajmë harxhimet administrative dhe harxhimet për mbledhje të të hollave në nivel minimal që të sigurojmë maksimalisht mjete të mundshme të arrijnë deri tek shfrytëzuesit.
- Ne do të sigurojmë që mjetet e fituara e shfrytëzohen vetëm për qëllimin e përcaktuar dhe donatorët të konsultohen për nevojën për ndryshime në planin e aksionit dhe buxhetin.
- Ne do të sigurojmë që tenderet dhe marrëveshjet e nevojshme, ta inkurajojnë pjesëmarrjen e ndërmarjeve të vogla dhe te reja, sidomos ata të cilat janë pronë e sektorëve të mëparshëm të diskriminuar të shoqërisë sonë.
- Ne do të japim kontabilitete të qartë dhe transparent të anëtarësisë më të gjerë dhe / ose të shfrytëzuesëve të organizatës.

E. Resurse

Kemi nevojë prej sistemeve që të udhëhiqet me mjetet e organizatës në mënyrë të qëndrueshme dhe mënyrë e cila i redukton harxhimet. Kjo është instrument me rëndësi në sektorin e mirëmbajtjes së vlerave të tij të efikasitetit dhe efikasitetin në punën tonë. Për këtë qëllim:

- Ne do të zhvillojmë veprime interne dhe mekanizma kontrolluese dhe të njejtat do t'i imlementojmë që të sigurohet shfrytëzim i rregullt i mjeteve të organizatës dhe qartë të ndahet shfrytëzimi is organizatës nga shfrytëzimi privat.
- Ne do të zhvillojmë dhe imlementojmë mekanizma për mbikqyrje të shfrytëzimit të kohës së të punësuarëve.
- Ne do të bëjmë analiza periodike lidhur me harxhimet dhe dobia e projekteve dhe do t'i shqyrtojmë alokacionet e resurseve në dritë të të njejtave.

A N E K S I 3

QEÇP qendra rajonale të OJQ-ve

A. Qëllimet

Në kuadër të konceptit të QEÇP Rrjetit të OJQ-ve për përmirësim të marrëdhënieve ndëretnike në Republikën e Maqedonisë do të themelohet një numër i caktuar i *QEÇP Qendrave rajonale të OJQ-ve* (në tekstin e mëtejshëm “Qendra Rajonale”). Këto Qendra Rajonale do të kenë për qëllim përmirësimin e tolerancës ndëretnike, respektin për dallimet dhe dialogun mes gjithë bashkësive në Republikën e Maqedonisë. Me këtë qëllim, ato do të punojnë në përfortim të kapacitetit të OJQ-ve anëtare të cilat janë nënshkruese të këtyre qëllimeve, do ta ndihmojnë zhvillimin e projekteve ndëretnike në bazë të prioritetëve lokale dhe mbështetje për implementim të të njejtëve.

B. Anëtarësimi dhe qasja

Qendrat rajonale do t’i shërbejnë bashkësisë lokale të OJQ-së të përkushtuar këtyre qëllimeve. Qendrat rajonale në të njejtën kohë do të sigurojnë forum të dialogut mes popullatës lokale dhe pushtetit lokal nga njëra anë dhe OJQ-ve anëtare nga ana tjetër.

Anëtarësimi i OJQ-ve në Qendrat rajonale në suaza më të gjera do ta reflektojë përbërjen etnike të bashkësisë lokale, përderisa numri i anëtarëve do të ndryshojë prej Qendre në Qendre, duke pritur numër mesatar prej 15 anëtarësh.

Anëtarësimi Në qendër resurse të OJQ lokale nënkupton anëtarësim në QEÇP. Rrjetin e OJQ për përmirësim të marrëdhënieve ndëretnike në Republikën e Maqedonisë (në tekstin më poshtë Rrjeti). Kriteret për anëtarësim janë të formuara nga ana e rrjetit në Aneksin 1. Përderisa Qendra rajonale nuk numëron 10 OJQ anëtarë, duke inkuadruar përfaqësim të plotë të të gjitha entiteteve në atë rajon, vendimet për anëtarësim në Qendrën përkatëse rajonale do të sillen në nivel të Rrjetit, pas revidimit të keshillës së Qendrës rajonale. Atëherë kur numri i anëtarëve në qendrën do ta tejkalojë numrin 10, dhe që kur Rrjeti do të konfirmojë se kjo anëtarësi është mjaft reprezentative, që atëherë ajo vetë do të vendosë për anëtarësim të reja në pajtueshmëri me kriteret e dhëna në Aneksin 1.

Vendimi për përjashtim të ndonjë anëtari të Qendrës rajonale do të sillen në atë qendër në pajtueshmëri me principet e sjelljes së vendimeve të sqaruara më lart, kurse në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në Aneksin 1, alinea 11, i cili vendim është lëndë konfirmimi nga Rrjeti, dhe në pajtueshmëri me procedurat e përcaktuara për atë qëllim.

C. Linqe me bashkësitë lokale dhe pushtetet lokale

OJQ-të të cilat bashkëpunojnë nëpërmjet QEÇP Qendrave rajonale të OJQ-ve do t'u dalin përballë nevojave të bashkësive lokale. Atëherë kur Qendrat rajonale do t'i përcaktojnë fushat me prioritet për zhvillim të projekteve, ato do t'i konsultojnë përfaqësuesit e bashkësisë rreth nevojave lokale dhe mënyrat më të mira për plotësimin e tyre. Konsultimet e këtilla bëhen periodikisht.

Qendrat rajonale do të kërkojnë bashkëpunim nga ana e administratës lokale, duke e mbajtur gjatë kësaj pavarësinë e tyre të plotë dizajnimin dhe prezentimin e projekteve të tyre. Me këtë rast, do të mbahen konsultime të rregullta.

Ç. Programe dhe aktivitete

Krahas prezentimit të projekteve të cilat do të realizojnë dobi të drejtpërdrejtë për bashkësitë lokale si rezultat i bashkëpunimit ndëretnik të OJQ-ve, Qendrat rajonale do t'i ofrojnë shërbimet e mëposhtme.

- Ndhimë OJQ-ve anëtare për përmirësimin e kapaciteteve të tyre nëpërmjet stërvitjes
- Sigurim të kushteve për bashkëpunim ndëretnik të OJQ-ve
- Ndhimë gjatë zhvillimit të projekteve të përbashkëta dhe përkrahje të tyre para donatorëve
- Ndhimë gjatë mbledhjes të mjeteve për projekte
- Përkrahje gjatë realizimit të projekteve
- Sigurim të mirëmbajtjes, transparencës dhe sinqeritetit për projektet dhe vlerësimin e rezultateve
- Ngritje të profilit të këtij lloji të bashkëpunimit të OJQ-ve në nivel lokal dhe nacional
- Përfaqësim të interesave, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha OJQ-të dhe njëkohësisht të domosdoshme për funksionimin e tyre të suksesshëm në nivel lokal.
- Të sigurojë se cikli i Zhvillimit të Propozim Projektit është i ndjekur.
- Raportim mujor për shpenzimet e QR-së (anëtarëve të QR-së).
- Anëtarët e Qendrës Rajonale do të zgjedhin Koordinator dhe Ndhimës Koordinator, i cili do të jetë përgjegjës për të mëposhtmen:
 1. Të organizojë mbledhje;
 2. Ta përfaqësojë QR-në para opinionit;
 3. Të llojë;
 4. Ta implementojë Planin e Aksionit;
 5. Ta përfaqësojë QR-në në trupin koordinues si anëtarë;T'i stimulojë OJQ-të e Rrjetit të punojnë drejt arritjes së planit të aksionit;

D. Funkcionimi i Qendrave rajonale

Gjthë anëtarët do t'i kryejnë të gjitha aktivitetet e tyre në pajtueshmëri me standardet e Rrjetit. Qendrat rajonale mund të sjellin vendime në pajtueshmëri me aktivitetet e lartpërmendura. Vendimet kyçe në lidhje me aktivitetet e Qendrës do të sillen me principij e shumicës së të gjithë anëtarëve të Rrjetit, në të njejtën kohë lëndë nën kompetencat e Rrjetit.

Një herë në vjet, Qendra përcakton prioritetet për zhvillim të projekteve lokale të OJQ-ve, pas konsultimeve me përfaqësues të popullsisë lokale dhe pushteteve lokale, kurse në pajtueshmëri me suksesin e projekt ciklit të mëparshëm. Qendrat rajonale do ta përforcojnë përkrahjen e projekteve të cilat janë në pajtueshmëri më prioritetet e përcaktuara, edhe pse kjo nuk e përjashton mundësinë e aprovimit të projekteve tjera.

Gjatë sjelljes së vendimit për përkrahje të zhvillimit dhe financimit të projekteve, Qendrat rajonale do të udhëhiqen nga këto faktorë:

- Kapacitetit të OJQ-së e cila e propozon projektin dhe natyrën multietnike të federatës së OJQ-ve të cilat e propozojnë projektin
- Realizimi dhe mirëmbajtja e projektit
- Përshtatshmëria e projektit me nevojat prioritare të identifikuar nga Qendra rajonale
- Dispozitat për transparencë dhe sinqeritet gjatë realizimit të projektit

Qendrat rajonale do të zhvillojnë plane vjetore të aktiviteteve të tyre në pajtueshmëri me prioritetet e përcaktuara dhe do t'i prezantojnë raportet vjetore për aktivitetet e implemetuara nga ana e OJQ-ve nën sponsorimin e tyre.

Qendrat rajonale mund të rekomandojnë projekte të vogla për financim direkt nëpërmjet QEÇP. Ato gjithëashtu mund të rekomandojnë që QEÇP të sigurojë financim fillestar për zhvillim të plotë të propozim projekteve më të mëdha të cilat premtojnë. Qendrat rajonale, gjithëashtu mund të rekomandojnë financim të pjesërishëm nga ana e QEÇP, si mënyrë e tërheqjes së më shumë financierëve. Qendra propozon një projekt të caktuar të mirret nga infrastruktura e Rrjetit nacional me qëllim të lobimit për mbështetje donatore.

Njëkohësisht, Qendrat rajonale pajtohen me prioritetet për stërvitje të përcaktuara nga Rrjeti si edhe me programin për stërvitje.

Qendrat rajonale do të themelojnë Komitet ekzekutues, përgjegjës për mirëmbajtjen e operacioneve rutinore të pajtuara nën udhëheqje të antarësisë së plotë. Komiteti ekzekutues njëkohësisht do ta përfaqësojë Qendrën në kontaktet me Rrjetin dhe Qendrat tjera rajonale.

DH. Kriteriumet për funksionimin e vazhdueshëm të QR-së

- Mbledhje të rregullta të OJQ-ve anëtare të QR-së në pajtueshmëri me kворumin e arritur (së paku dy herë në muaj)
- Organizim i obliguar i forumeve qytetare në pajtueshmëri me planin vjetor për aksion të QR-së. Në rast se forumi nuk është i organizuar në kohën e planifikuar, e njejta të kompenzohet në periudhën që vjen.
- Të gjenerohen propozim projekte nga forumet e mbajtura, minimum një propozim çdo tre muaj.
- Gjitha qendrat janë përgjegjëse për implementimin minimum një projekti të përbashkët ndëretnik brenda nje periudhe kohore prej gjashtë muajsh, ose dy projekte në vjet.
- Projektet e implementuara në QR do t'i prezentohen tërësisht Rrjetit Nacional, me mundësi për implementimin e tyre në nivelin nacional.
- Qendrave, të cilat do të dështojnë të funksionojnë në pajtueshmëri me kriteret e lartpërmendura mund tu ndërpriten dhe të njejtat të mbyllen.

E. Ndërprerja e punës së QR-së

Vendimi për ndërprerjen e punës së një QR-je mund të silltet me dy të tretat e votave të anëtarëve të asaj Qendre. Rrjeti, i cili funksionon nëpërmejt Kuvendit të provizionalisht nëpërmjet Trupit Koordinues gjithëashtu mban të drejtën për sjelljen e një vendimi të këtillë, në pajtueshmëri me mekanizmat e MpB, në rast se QR-ja nuk i respekton kriteret për vazhdueshmëri nga paragrafi VI në Aneksin 3.

Në rast të mbylljes së QR-së, e tërë pajisja materiale dhe teknike i kthehet Rrjetit, së bashku me fondet e mbetura financiare të QR-së përkatëse. Më tej, këshilli i Trupit Koordinues të QEÇP-së do të vendosë ku t'i reallojë këto të holla.

Në rast të mbylljes së QR-së, QEÇP-ja mban të drejtën ta rihap të njtën Qendër Rajonale me një kompilim të ri të anëtarëve. QEÇP mund ta ndërpresë financimin e një Qendre Rajonale e cial haptazi dështon të arrijë qëllimin e një Qendre Rajonale.

Ë. Infrastruktura

Qendrat rajonale janë shoqata të OJQ-ve anëtare, të cilat bashkëpunojnë nëpërmjet infrastrukturës së siguruar nga ana e QEÇP dhe me aktivitete të ndihmuara nga ana e QEÇP. QEÇP do të themelojë zyrë të vogël për Qendrat rajonale, do të sigurojë kushte themelore kompjuterike dhe komunikative, etj. Operacionet rutinore të Qendrave rajonale do të jenë nën kompetencat e OJQ-ve lokale. QEÇP, nëpërmjet zyrës së vet në Shkup, siç është dhënë më lart, do t'i përkrahë këto aktivitete duke përfshirë edhe stërvitjen.

F. Marrëdhëniet me Rrjetin nacional dhe bashkëpunimi mes Qendrave rajonale

Qendrat rajonale do të funksionojnë në kuadër të konceptit të plotë të *QEÇP Rrjetit për përmirësim të marrëdhënieve ndëretnike në Republikën e Maqedonisë* nacionale, me qëllim të përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike. Rrjeti do të themelojë principe të përgjithshme të të vepruarit dhe kahëzuarit, të cilat njëkohësisht do të vlejnë edhe për Qendrat rajonale. Rrjeti do t'i koordinojë ofertat për stërvitje, do të mbajë Web-resurse nacionale si platformë në të cilën OJQ-të anëtare do të kenë mundësinë t'i prezentojnë profilet dhe aktivitetet e tyre, si dhe të sigurojnë informata për financim të pyetjeve të ngjajshme të OJQ-ve anëtare dhe do të ndihmojnë në prezentimin e propozim projekteve të cilat dalin nga Qendrat rajonale ose prej Rrjetit para financuesëve.

Qendrat rajonale gjithëashtu do të tentojnë t'i koordinojnë aktivitetet e tyre nepërmjet kontakteve të drejt për drejta mes tyre, dhe nepërmjet mbështetjes së punës së komiteteve të specializuara brenda Qendrave Rajonale dhe Trupit Koordinues.

Rekomandohet që Qendrat rajonale të kenë ndihmës teknik me orar të plotë pune me qëllim të sigurimit të funksionimit të vazhdueshëm të Qendrës.

ANËTARËSIA ASOCIATIVE

- Mbajtja e karakterit multietnik të Qendrës Rajonale gjatë pranimin të anëtarëve të rinjë asociativ.
- Rekomandohet përfaqësim maksimal sektoral gjatë pranimin të anëtarëve asociativ, me këtë duke rritur kapacitetin e përgjithshëm të Qendrës Rajonale për të drejtuar një opus të gjerë të sektorëve.
- Degët rajonale të OJQ-ve anëtare mund të aplikojnë për tu bërë anëtarë të Qendrës Rajonale dhe me këtë të fitojnë statusin e anëtarëve asociativ pa të drejta vote në Kuvendin Gjeneral ose në Qendrën Rajonale.